



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primi/jevoj/Prodato Received / Delivery	22.12.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHIK	8378	/2022	1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1030/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtare, si dhe Sabile Avdyli, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1030/2022 të datës 21.11.2022 të parashtruar nga ankuesi të cilin e përfaqëson me autorizim Av.

me adresë

kundër organit të punësimit, Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës/MFPT në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 22.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

**I. Apropohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1030/2022 e datës 03.11.2022 e parashtruar nga ankuesi**

**II. Detyrohet Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të inicoj veprimet e nevojshme ligjore-administrative për harmonizimin e koeficientit të pagës së nëpunësit civil Bashkim Asllani nga koeficienti shtatë pikë pesë (7.5) pikë në koeficientin tetë (8).**

**III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës/MFPT, që të kujdeset për zbatim të pikës II të këtij vendimi .**

**IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**



## Arsy et im

Ankuesi i punësuar sipas Akt emërimit me numër Nr.272 të datës 18.12.2018, në pozitën "Udhëheqës i Zyrës së Punësimit në Vushtrri" në kuadër të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me datën 21.11.2022 ka parashtruar ankesë A.nr.1030/2022 me numër protokoll 7251/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me realizimin e të drejtës për harmonizimin e koeficientit nga shtatë pikë pesë (7.5) në tetë (8).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 25.11.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Punësimit në Republikën e Kosovës, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 06.12.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesën e ankuesit nga Agjencia e Punësimit në Republikën e Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 21.11.2022 me numër protokoll 7251/2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 25.11.2022 me numër protokoll 7417/2022; Përgjigje në ankesë e datës 06.12.2022 nga organi i punësimit me numër protokoll 7706/2022 bashkë me shkresat e lëndës; Akt emërimi i datës 18.12.2018; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Zyrës së Punësimit; Akt emërimi i datës 18.12.2018 ; Kërkesa për harmonizimin e pagës e datës 10.08.2022; Përgjigje në kërkesë e datës 09.11.2022 nga organi i punësimit lidhur me ngritjen e koeficientit; Kopja e konkursit të brendshëm i datës 05.09.2018 dhe Vendimi me nr.342/2018 i datës 27.11.2018 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses është e bazuar, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave të lëndës Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesi me datën 10.08.2022 ka parashtruar kërkesën me nr.121/2022 tek Agjencia e Punësimit në Republikën e Kosovës në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve lidhur me realizimin e të drejtës për harmonizimin e koeficientit nga shtatë pikë pesë(7.5) në tetë (8). Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës, për kundër të detyrimit ligjor për nxjerrjen e aktit administrativ bazuar në dispozitat e LPPA-së, konform kërkesës së ankuesit, me datën 19.08.2022 organi i punësimit në procedurë jo të rregullt administrative i refuzon të njëjtit kërkesën për ngritje të koeficientit nga se nuk ka bazë ligjore, por pa nxjerrë akt administrativë ashtu si parashihet me dispozitat e Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative. Ankuesi i pakënaqur me përgjigjen e organit të punësimit me datën 30.08.2022 ka parashtruar ankesën me numër protokoll 5026/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Këshilli me datën 24.10.2022 ka nxjerr vendimin A.nr.745/2022 me numër protokoll 6421/2022 me të cilin detyron Drejtorin e



Përgjithshëm në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të nxjerrë akt administrativ lidhur me kërkesën e datës 10.08.2022, të parashtruar nga ankuesi

Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës me datën 09.11.2022 i është përgjigjur në kërkesën e ankuesit të datës 10.08.2022 ,përmes së cilës shkresë e ka refuzuar kërkesën me arsyetimin se nuk mundet me u realizue harmonizimi i pagës nga shtatë pikë pesë(7.5) në tetë (8), sikurse në Komunat e tjera të nivelit regional në Republikën e Kosovës sepse numri i stafit në këto komuna është nga 11 deri 15 zyrtar ndërsa në komunat tjera të madhësisë si është Komuna e Vushtrrisë stafi është nga 2 deri në 4 zyrtar.

Ankuesi i pakënaqur me përgjigjen e datës 09.11.2022 nga organi i punësimit, me datën 21.11.2022 përmes përfaqësuesit të autorizuar Av. \_\_\_\_\_ ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7251/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 19 ku përcaktohet se: *"Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave"* si dhe nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil me të cilin parashihet se: *"1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara më këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë...., dhe rrjedhimisht konstatoj së e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësit civil të cilët kryejnë detyra të ngjashme të punës dhe që kanë kualifikime dhe përvojën e kërkuar për pozitën respektive, duhet të realizojnë pagë të njëjtë.*

Andaj, në vështrim të dispozitave ligjore si me lartë bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se organi i punësimit respektivisht Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës lidhur me pozitat *"Udhëheqës të Zyrave të Punësimit"* si pozita të kategorisë së njëjtë aplikon koeficient të ndryshëm të pagës, gjegjësisht Kolegji nga provat materiale ka konstatuar se *"Udhëheqësi i Zyrës së Punësimit"* në Vushtrri ka koeficient shtatë pikë pesë (7.5) të pagës; ndërsa në Komunat tjera të njëjtit zyrtarë për nga niveli kanë koeficient tetë(8),ndërsa kjo rrethanë është konfirmuar edhe sipas shkresës së datës 09/11/2022 nga organi i punësimit me rastin e përgjigjes në kërkesë ndaj ankuesit, Kështu që bazuar në këto fakte Kolegji vlerëson se aplikimi i koeficienteve jo të njëjtë të pagës për pozita të kategorive të njëjta, paraqet trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të stafit brenda institucionit të njëjtë punëdhënës ashtu siç është përcaktuar me nenin 4 paragrafi 1 Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi ku thuhet se: *"Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji"*, rrjedhimisht në vlerësimin e Kolegjit trajtimi jo i barabartë dhe diskriminues i të punësuarve të njëjtit institucioni në kuptim të së drejtës së pagës është në kundërshtim të plotë edhe me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit për Zyrtarët Publikë më të cilin është përcaktuar se: *"1. Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik*





*dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë...”*

Nga sa u tha më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se organi i punësimit konkretisht Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit në Republikën e Kosovës, është i obliguar që konform këtij vendimi dhe dispozitave ligjore të ndërmarr veprimet juridike që të bëjë harmonizimin e koeficientit për ankuesin nga shtatë pikë pesë (7.5) në tetë (8).

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.1030/2022, datë 22/12/2022.

Sabile Avdyli



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës në MFPT;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës në MFPT dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

